

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Pas shpalljes së pafajësisë, GJKKO heq sekuestron mbi pasuritë e ish-gjyqtarit Shkëlzen Selimi
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/23/pas-shpalljes-se-pafajesise-gjkkko-heq-sekuestron-mbi-pasurite-e-ish-gjyqtarit-shkelzen-selimi/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:50:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 07:54:32 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	61b1e618c4c965840bf2ac55a7adec2f3be863b64127eecbb6b9a07884f84f06
TEKSTI	9e0e1a7b11b54ae5e5f4dab935e3331708defb1dc2fc03f2516aebd1e6e7abc9
PAMJA	5330066211980c075b21005cb8c88a8fbff355c437de8795521f66171c690bc

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	5c30b7786905dbe4163d82426a2feb532607144274db6eb6fbd1d9ca0293847
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/5c30b7786905dbe4163d82426a2feb532607144274db6eb6fbd1d9ca0293847>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Pas shpalljes së pafajësisë, GJKKO heq sekuestron mbi pasuritë e ish-gjyqtarit Shkëlzen Selimi

Kronike

Publikuar: 23/09/2026

f X



Gjkata e Posaçme ka hequr masën e sekuestros për disa pasuri të ish-gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, Shkëlzen Selimit, duke dhënë si argument “mosplotësimin e kushteve ligjore për vazhdimin e saj mbi pasuritë objekt të këtij gjykimi.”

Konkretisht, janë hequr nga sekuestroja ½ e një karburanti në Lungomaren e Vlorës, një truall me sipërfaqe 2,400 m² në Jonufër dhe një pikë tjetër karburanti në ‘Transballkaniken’ e Vlorës.

Këto dy të fundit janë të regjistruara në emër të një personi tjetër, Kujtim Selimi.

Tashmë Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara do të njoftojë palët dhe do të ekzekutojë vendimin pas 15 ditëve.

Pasuritë e Selimit *u sekuestruan në vitin 2021* nga SPAK që nga hetimi penal zbuloi të dhëna që 3 ish-gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe asaj të Lartë, kishin në pronësi pasuri të paluajtshme, të cilat nuk i justifikonin me burime të ligjshme.

Më pas, në tetor 2022, SPAK e *dërgoi çështjen në gjykatë* duke e akuzuar Selimin për deklarim të rremë pasurie. Në 2025, Gjykata e shpalli *ish-gjyqtarin të pafajshëm* ndërsa Prokuroria e Posaçme e ankimoi çështjen në Apelin e GJKKO që *la në fuqi* vendimin e shkallës së parë.

Shkëlzen Selimi punoi për dy dekada në sistemin e drejtësisë, përpara se të shkarkohej në vitin 2018 nga vetingu për fshehjen e kontakteve me persona të përfshirë në krim të organizuar. Edhe bashkëshortja e tij, ish-gjyqtarja e Apelit Administrativ, Rilinda Selimi, u shkarkua nga Kolegji për shkak të kontakteve të nënërshtetshme, megjithëse shumica e trunit gjyqësor nuk

Me te lexuarat



Gratë e PD-së që u shtrinë në zyrën e Gys Agasit, njëra u shfaq me makinë 70 mijë \$



“Do përfundojmë keq shpirt”. Si raportonte kryeagjentja Vlora Hyseni te



Benet Becit, si po i pastron paratë e korrupsionit



te gjithe e dinin në Baku, Vlora Hyseni shfaqet në Kosovë dhe dorëzohet te



Isufi dhe Mauro Borghi që helmojnë shqiptarët me djathë me baktere të rrezikshme, ...

papërshtetshmërie, megjithatë shtetshme e trup gjykues nuk konstatoi probleme për pasurinë e saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar** më datë **03.11.2022** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: "Konfiskimin e pasurive të paluajtshme në zotërim të shtetasit **Shkëlzen Selimi**; persona të lidhur: K.S., R.S.". Baza ligjore, ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 "*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*".

2. Në përfundim të gjykimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Flora Hajredinaj, me vendimin nr. **14**, datë **22.09.2026**, vendosi:

I. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

Revokimin e masës së sekuestrës, të vendosur me vendimin nr. 10, datë 23.04.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për shkak të mosplotësimit të kushteve ligjore për vazhdimin e saj mbi pasuritë objekt të këtij gjykimi, si më poshtë:

1. ½ e pasurisë me nr.****, volumi ****, faqe ****, zona kadastrale ****, me vendndodhje ****, adresë lagjia ****, në pronësi të shtetasit **Shkëlzen Selimi**.

2. Pasuria me nr. ****, zona kadastrale ****, e regjistruar në volum ****, faqe ****, truall me sipërfaqe 2400 m2, adresa e pasurisë **** (pasuri e përbërë nga bashkim pasurie) në pronësi të shtetasit K.S.

3. 55% e pasurisë me nr. ****, zona kadastrale ****, regjistruar në volum ****, faqe ****, e llojit truall me sipërfaqe 764 m2 dhe godinë me sipërfaqe 57 m2, adresa e pasurisë ****, pronësi e fituar me kontratën nr. **** rep., nr. ****kol., datë 15.6.2017, paguar në këtë datë vlera 40,000 euro, në pronësi të shtetasit K.S (përcaktuar pjesët takuese midis bashkëpronarëve me urdhrin nr. ****, të muajit gusht 2018).

II. Ky vendim t'i përcillet Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, e cila njofton pronarin e pasurive të sekuestruara dhe vihet në ekzekutim 15 ditë pas njoftimit të palëve të interesuara.

III. Shpenzimet gjyqësore sikurse janë bërë.

IV. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 22.09.2026

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

Rruga "Jordan Misja", nr.1, 1057 Tiranë; tel/fax 042225075; gjykata.gov.al

/shqiptarja.com

TAG:

Gjtkko

Shkëlzen selimi

Të ngjashme



E përfshirë në dosjen e Ergys Agasit/ Ish drejtoresha e SHISH, Vlora Hyseni nesër para GJKKO



Vlora Hyseni në arrest shtëpie, Elvis Lila merr përkohësisht drejtimin e SHISH-it

Dokumenti/ Vlora Hyseni ishte propozuar në gusht nga Franca për gradën "Kalorës" të Urdhrit Kombëtar të Meritës

Prapaskena

'Prapaskena' lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. 'Prapaskena' është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.'

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU](#) [INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.